

E DREJTA E INFORMIMIT 2023

Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit -
Shumë zhurmë për asgjë?

Mars 2024
Botimi IX



Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës “Res Publica” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet se reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Autorë:

Av. Dorian Matlija
Dr. Irena Dule
Av. Brunilda Qershori

Botues: Qendra “Res Publica”
Redaktor: Dorian Matlija
Tirazhi: 200 kopje
Kopertina: Jona Xhufi
Layout & Print: Expo Vision Albania

© Res Publica 2024

E DREJTA E INFORMIMIT 2023

Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit-
Shumë zhurmë për asgjë?

PËRMBAJTJA

5 Hyrje

7 Metodologjia

9 Vlerësimi i punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

9 Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

9 Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

11 Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

11 Llojet e vendimeve të Komisionerit

13 Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri

13 Aplikimi i sanksioneve

15 Transparenca e Autoriteteve Publike

15 Reagimi i autoriteteve publike ndaj kërkesave për informacion

19 Vlerësimi i transparencës proaktive

25 Çështje me interes të veçantë për të drejtën e informimit, gjatë vitit 2022

25 Agjencia e Medias dhe Informacionit trajton më pak kërkesa nga sa pritej

27 Proceset legjislative gjatë vitit 2023

33 Tarifat e vendosura nga autoritetet, një "doganë" për marrjen e informacionit

34 Autoritetet publike refuzojnë dhënien e informacionit edhe pasi Gjykata vendos dhënien e tij, duke u bërë pengesë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

35 Asnjë hap pozitiv drejt transparencës së veprimtarisë së sistemit gjyqësor

39 Të dhëna nga platforma “Publeaks.al”

39 Përdorimi i faqes Publeaks.al

40 Aplikantët sipas grupmoshave

41 Aplikantët sipas arsimimit

41 Aplikantët sipas gjinisë

43 Konkluzione

43 Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion

43 Për sa i përket programeve të transparencës

44 Për sa i përket strukturës së zbatimit të ligjit

45 Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

46 Për sa i përket çështjeve të veçanta

47 Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit

49 Rekomandime

I. HYRJE

Ky raport u përgatit nga Qendra Res Publica, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit në Shqipëri”

Viti 2023 është viti i nëntë rradhazi që Res Publica monitoron zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, tashmë i ndryshuar me ligjin nr. 78/2023, dhe viti i dhjetë duke përfshirë edhe zbatimin e ligjit të mëparshëm të vitit 1999. Njëlloj si herët e tjera, monitorimi është kryer duke pasur në fokus nga njëra anë interesin e qytetarëve dhe sidomos gazetarëve për të përdorur të drejtën për t’u informuar dhe nga ana tjetër sjelljen e autoriteteve publike për garantimin dhe respektimin e të drejtës për t’u informuar.

Edhe këtë vit Res Publica ka monitoruar zhvillimet në këtë fushë duke vijuar me testimin aktivisht të efektivitetit të ligjit, me fokus të veçantë në kërkimin e informacionit me sensitivitet të lartë, aty ku perceptohet se ka më shumë dobësi, të cilat përbëjnë shteg për zyrtarët që nuk dëshirojnë të japin informacionin e kërkuar. Aktiviteti kryesor gjatë këtij viti ka qenë miratimi i disa ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që erdhi pas një procesi konsultimi dhe hyri në fuqi në 4 nëntor 2023.

Në këtë raport trajtohen edhe çështje të tjera veçanta, si tarifat e marrjes së informacionit, vështirësitë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, anonimizimi i vendimeve gjyqësore, si dhe veprimtaria e Agjencisë për Media dhe Informacion, e krijuar në vitin 2021, që synon të rregullojë marrëdhëniet publike të organeve të ekzekutivit dhe ku një prej aspekteve që trajtohen është edhe informimi i gazetarëve nga autoriteteve publike dhe konfuzioni që krijohet nga mpleksja e dy rregullimeve të ndryshme.

Raporti edhe për këtë vit prezanton rezultatet që kanë dalë nga përpunimi i të dhënave të marra nga platforma Publeaks.al për vitin 2023, e cila u krijua nga Res Publica në Dhjetor 2016 për t’i ardhur në ndihmë gazetarëve, studiuesve dhe qytetarëve aktivë që dëshirojnë të informohen për çështje të ndryshme të veprimtarisë shtetërore, duke lehtësuar aksesin e

tyre në informacionin publik. Një version i aplikacionit mobile është zhvilluar për lehtësuar aksesin në këtë platformë.

Raporti shoqërohet me rekomandime konkrete në shërbim të rritjes së transparencës nga autoritetet publike.

Përgatitën raportin:

Av. Dorian Matlija

Dr. Irena Dule

Av. Brunilda Qershori

II. METODOLOGJIA

Ky raport ka për qëllim monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2023 duke bërë krahasimin e zbatimit të tij me vitet paraardhëse. Për përgatitjen e këtij raporti janë monitoruar programet e transparencës së 100 autoriteteve publike kryesore, duke marrë një kampionim prej 20 autoritetesh publike nga 5 kategori si: (1) autoritete kushtetuese dhe të pavarura; (2) autoritete të pushtetit ekzekutiv qendror; (3) autoritete varësie të pushtetit ekzekutiv; (4) autoritete të pushtetit vendor; (5) autoritete të drejtësisë. Ligji “Për të drejtën e informimit” i jep rëndësi transparencës proaktive si një mundësi e transparencës që çdo autoritet publik duhet ta zhvillojë në kryerjen e veprimtarisë së tij. Edhe me ndryshimet ligjore që hynë në fuqi në Nëntor 2023, programeve të transparencës i është dhënë rëndësi. Sipas amendamentit, tashmë çdo autoritet publik duhet të publikojë edhe datën e përditësimit të dokumentacionit të ndryshuar në faqe.

Ashtu si dhe në vitet e tjera, Res Publica ka dërguar mbi 200 kërkesa për informacion, për të testuar sjelljen e institucioneve. Kërkesat i janë drejtuar institucioneve të ndryshme, duke përfshirë pushtetin qendror, pushtetin vendor, drejtësinë, autoritetet e pavarura si dhe autoritetet e varësisë së pushtetit ekzekutiv. Po ashtu, edhe objekti i kërkesave ka qënë i larmishëm duke prekur disa fusha të ndryshme si mjedisi dhe burimet natyrore; energjia elektrike; ekonomia; prokurimet publike etj. Për testimin e tyre janë marrë në konsideratë elementët si: saktësia e përgjigjeve, koha e kthimit të përgjigjes, ankimet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, reagimi i autoriteteve publike pas ankimit etj. Të gjitha gjetjet pasqyrohen në mënyrë grafike duke bërë edhe krahasimin e zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” ndër vite.

Një nga elementët e trajtuar në këtë raport është dhe veprimtaria dhe roli që kanë autoritetet, me fokus të veçantë veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por duke përfshirë edhe autoritete të tjerë si Agjencia për Media dhe Informacion.

Për vitin 2023, është monitoruar vlerësimi i veprimtarisë së Komisionerit duke marrë në analizë numrin e ankesave të adresuara pranë këtij institucioni, cilët kanë qënë ankuesit, si

ka disponuar Komisioneri në lidhje me ankesat, llojet e vendimeve të marra, aplikimin e sanksioneve dhe afatin për brenda të cilit ka realizuar vendimmarrjen. Të gjitha këto të dhëna janë krahasuar me të dhënat e viteve të kaluara e cila paraqet dhe një panoramë krahasuese lidhur me veprimtarinë e Komisionerit.

Në mënyrë të veçantë është pasqyruar edhe çështja e ndryshimeve të ligjit “Për të drejtën e informimit” në vitin 2023.

III. VLERËSIMI I PUNËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni përgjegjës që kujdeset për zbatimin e ligjit nr.119/2024 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë e tij Komisioneri duhet të kujdeset për zbatimin e ligjit në dy plane: (1) garantimin e transparencës reaktive, duke trajtuar ankesat për refuzimin e dhënies së informacionit, si dhe; (2) garantimin e transparencës proaktive, për plotësimin e programeve të transparencës nga autoritetet publike.


Ndryshimet ligjore të vitit 2023 (me ligjin nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”), solli ndryshime sa i takon dhe kompetencave të Komisionerit në monitorimin e zbatimit të ligjit.

Gjatë viteve 2015-2023 Komisioneri ka krijuar një praktikë me 375 vendime që interpretojnë aspekte të ndryshme të ligjit, ndërkohë që i janë paraqitur afro 6800 ankesa gjatë gjithë këtyre viteve.

Res Publica ka raportuar vazhdimisht se zyra e Komisionerit ka pasur një qasje të butë ndaj fenomeneve negative dhe nuk ka arritur të garantojë plotësisht zbatimin e ligjit në mënyrë efektive, në përputhje me pritshmëritë e ligjvënësit, gazetarëve dhe shoqërisë civile.

Edhe për këtë vit, Res Publica ka monitoruar veprimtarinë e Komisionerit lidhur me zbatimin e ligjit për transparencën reaktive. Për efekt të monitorimi është marrë informacion zyrtar prej zyrës së tij si dhe prej verifikimit të regjistrit në faqen pyetshtetin.al, mënyra e trajtimit të ankesave, monitorimi i vendimeve të dhëna të publikuara në faqen zyrtare të tij, etj.


3.1. Numri i ankesave drejtuar Komisionerit



Për vitin 2023 numri i ankesave drejtuar Komisionerit është 956. Pavarësisht se ky numër ka pësuar ulje në krahasim me vitin 2022, duhet thënë se numri i ankesave është i lartë, krahasuar kjo dhe me vitet e tjerë të mëparshëm.

Siç rezulton nga testimi i qendrës Res Publica, në vijim të këtij raporti, gjatë vitit 2023 është rritur numri i përgjigjeve të plota dhe ka rënë numri i përgjigjeve të pjesshme me afro 12%, duke ndikuar në uljen e nevojës për t’u drejtuar me ankim Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

3.2. Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit¹




¹ Në kategorinë “Qytetarë” janë përfshirë edhe kërkesat e drejtuara nga avokatët, të cilët sipas Komisionerit për të Drejtën e Informimit, gjatë vitit 2023, kanë qenë në masën 2%. Avokatët në përgjithësi i drejtohen autoriteteve publike me kërkesa për informacion për interesa të klientëve të tyre, pavarësisht se ligji nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, përcakton në nenin 12 se avokatët janë subjekte të posaçëm për të kërkuar informacion nga autoritetet publike. Për këtë arsye, Res Publica i ka bërë pjesë të kategorisë “Qytetarë”.

Për vitin 2023 vihet re që numri i ankesave adresuar nga qytetarë është më i lartë se dy vitet e kaluara, duke ndjekur këtë trend që nga viti 2021. Nga ana tjetër, ky është një indikator që numri i ankesave nga gazetarët ka vijuar të bjerë, pavarësisht se mbetet ende kategoria kryesore që kërkon informacion.

3.3. Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

Në vijim tregohet se si është vendimarrja e Komisionerit në përfundim të shqyrtimit të ankesave:

Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri



Nga monitorimi i vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të Komisionerit, si dhe nga përgjigja zyrtare, rezulton se për vitin 2023 numri i vendimeve të dhëna nga Komisioneri është 45, shumë i afërt me mesataren e 8 viteve që nga nisja e zbatimit të ligjit nr. 119/2014. Ky numër ka pësuar ulje krahasuar me vitin 2022, i cili lidhet edhe me numrin më të vogël të ankesave.


Gjatë vitit 2023, përqindja e ankesave që janë trajtuar me vendim është **4.7%**, shifër e ngjashme kjo me vitet e kaluar.

3.4. Llojet e vendimeve

Sipas ligjit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit mund të disponojë me mospranimin ose pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, apo rrëzimin e ankesës, pjesërisht apo tërësisht.

Në rast të pranimit të ankesës, kur ai e gjykon të arsyeshme mund të vendosë edhe sanksionet përkatëse. Për vitin 2023 vendimarrja e Komisionerit paraqitet si më poshtë:

Llojet e vendimeve të Komisionerit



Për vitin 2023, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka disponuar me pranim, të plotë ose të pjesshëm, në 93% të rasteve, duke urdhëruar në këtë mënyrë autoritetin publik për të dhënë informacionin e kërkuar.

Një nga ndryshimet ligjore të vitit 2023 kishte të bënte dhe me shtimin e pikës 6/1 në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014, sa i takon zbatueshmërisë së vendimeve të Komisionerit. Sipas këtij ndryshimi parashikohet:

“6/1 Autoriteti publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij.”

Pavarësisht ndryshimeve ligjore, nga ana e ligjvënësit nuk është parë e arsyeshme për të klasifikuar vendimet e Komisionerit si tituj ekzekutivë, që mendohej se do të rriste efektivitetin në zbatimin e tyre. Një ndryshim pozitiv është lidhet me masën e dënimit me gjobë të autoritetit publik në rast moszbatimi të vendimit të dhënë prej Komisionerit².

Në praktikë, ky parashikim nuk e zgjidh plotësisht problemin e ekzekutimit të vendimeve të Komisionerit, sepse pavarësisht nëse ndaj një autoriteti publik, mund të merret masa administrative me gjobë për moszbatim të vendimit, sërish mund të ketë autoritete të cilat nuk ekzekutojnë vendimin dhe duke detyruar kërkuuesin t'i drejtohet Gjykatës përmes një procesi gjyqësor të zakonshëm.

Ideja e titullit ekzekutiv ishte pikërisht për të shmangur një gjykim të gjatë themeli dhe për të angazhuar përmbaruesin gjyqësor. Gjyba është vërtet një mjet presioni, por jo gjithmonë efektive.

Rruga gjyqësore shpesh herë kërkon energji, kohë dhe shpenzime për kërkuuesit. Këto elemente shumëfishohen në rastet kur mund të ndodhë që në praktikë vetë gjykata nuk njuh mirë standardet vendase dhe ndërkombëtare për të drejtën e informimit.


² Neni 12 shkronja “o” e ligjit Nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon: “moszbatimi i vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, sipas përcaktimve të pikës 6/1 të nenit 24 të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë”

Për më shumë informacion lidhur me këtë aspekt të posaçëm, mund të referoheni në kapitullin e çështjeve të veçanta në këtë raport.

3.5. Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri

Komisioneri me marrjen e ankesës ka detyrimin për tu shprehur me vendim në lidhje me këtë ankesë brenda 15 ditëve pune. Në praktikë ky afat është afro 21 ditë kalendarike.

Kohëzgjatja e vendimmarrjes së Komisionerit



Nga 45 vendime të marra nga Komisioneri për vitin 2023, afati 15 ditor është zbatuar vetëm në 4 % të rasteve, ndërsa në 96% të rasteve ky afat nuk është respektuar. Për vitin 2023, siç edhe shihet në grafik, është viti me përqindjen më të lartë të vendimeve jashtë afatit ligjor prej 15 ditësh pune. Një nga elementet që mund të ketë ndikuar në krijimin e kësaj situatë, mund të jetë edhe shtimi i seancave dëgjimore nga ana e Komisionerit, të cilat për këtë vit rezultojnë se janë zhvilluar në 19 raste kur ka disponuar me vendim (42% të rasteve). Në këto raste Komisioneri fillimisht ka ftuar palët në seancë dëgjimore, para se të dalë me një vendim. Mbajtja e një seance dëgjimore zakonisht sjell vonesa.

3.6. Aplikimi i sanksioneve

Numri i gjobave



Lidhur me sanksionet me gjobë, për vitin 2023 rezulton se nga 45 vendimet në total të dhëna nga Komisioneri, vetëm një rast është sanksionuar me gjobë. Ky është numri më i ulët i gjobave në të gjitha vitet, përveç vitit 2020 kur për shkak të anomalisë së krijuar nga pandemia e Covid 19, Komisioneri nuk aplikoi asnjë sanksion me gjobë.

Ndërkohë, sa i takon të dhënave personale, apo rasteve të transparencës proaktive, Komisioneri ka shfaqur më shumë ashpërsi në vendosje sanksionesh. Për vitin 2023, rezultojnë 19 vendime për të dhënat personale dhe për të 19 rastet ka disponuar me gjobë, ndërsa për transparencën proaktive Komisioneri ka disponuar me gjobë në 9 raste.

Në mënyrë të dukshme, për Komisionerin për të Drejtën e Informimit, përmbushja e programeve të transparencës ka marrë rëndësi parësore dhe kjo vihet re edhe te përmirësimi i tyre i ndjeshëm, që siç shihet në vijim të këtij raporti, ka një përmirësim relativ prej afro 20%. Ndërsa reagimi i autoriteteve publike për kërkesat për informacion, aspekti më i rëndësishëm i të drejtës për informim, duket se nuk ka pasur prioritet.

IV. TRANSPARENCA E AUTORITETEVE PUBLIKE

4.1. Reagimi i autoriteteve publike ndaj kërkesave për informacion

Prej vitesh Res Publica teston sjelljen e autoriteteve publike ndaj kërkesave për informacion, duke monitoruar përgjigjet e dhëna, afatin për kthimin e përgjigjes, etj. Për vitin 2023, Res Publica ka dërguar mbi 200 kërkesa për informacion drejtuar autoriteteve të ndryshme.

Analiza që pasqyrohet në vijim, bazohet mbi monitorimin e të njëjtëve komponentë me ato të analizuar në raportet e mëparshëm, në mënyrë që të bëhet një krahasim efektiv për të evidentuar dhe situatën ku ndodhemi për sa i takon reagimit të autoriteteve. Në mënyrë të përmbledhur janë marrë në konsideratë komponentë si:

- Fusha e informacionit të kërkuar;
- Kategoria e autoriteteve të pyetur;
- Sasia dhe cilësia e përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare;
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare;
- Reagimi i autoriteteve pas ankimit administrativ të Komisioneri;
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas depozitimit të ankimit administrativ.

4.1.1. Fusha e informacionit të kërkuar

Në të gjitha kërkesat për informim që dërgohen, Res Publica kujdeset që dhe kategoria për të cilën kërkohet informacioni të jetë i larmishëm, mundësisht të prekë çdo fushë, apo edhe herë pas herë për të kërkuar informacione sensitive apo me interes të lartë publik.


Për vitin 2023 është kërkuar informacion në fushat si më poshtë:

- Mjedisi dhe burimet natyrore;
- Energjia elektrike;

- Ekonomia;
- Punët publike;
- Arsimi;
- Rindërtimi;
- Drejtësia;
- Shëndetësia;
- Prokurime publike.

4.1.2. Reagimi i autoriteteve publike ndaj kërkesave fillestare

Sjellja e autoriteteve publike ndaj kërkesave fillestare për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:



Siç vihet re edhe në grafik, për vitin 2023 është rritur sasia e përgjigjeve të plota në masën 67%. Kjo përqindje është me larta e regjistruar deri më sot, më një përmirësim prej 13% nga viti i kaluar, ose e thënë në kuptimin relativ, përmirësimi është në masën 24%.


Niveli i përgjigjeve të pjesshme ka rënë në 6% nga 18% që ishte vitin e kaluar dhe niveli i mospërgjigjeve është pothuajse njëjloj me vitin e kaluar, duke mbetur në masën 27%.

Vihet re që për vitin 2023 ka një përmirësim të përgjigjeve, duke i dhënë ato më të plota, ndërsa autoritetet që nuk përgjigjen mbeten në të njëjtin nivel. Dhënia e përgjigjeve më të plota ka të ngjarë që të ketë shmangur në shumë raste ankimin te Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

4.1.3. Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare

Sipas ligjit, autoritetet publike kanë detyrimin të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së një kërkesë për informacion. Shpejtësia e kthimit të përgjigjeve në praktikë është si më poshtë:

Kohëzgjatja e përgjigjes pas kërkesës fillestare (ditë kalendarike)




Për vitin 2023 rezulton të ketë një ngadalësim të shpjëtësisë së kthimit të përgjigjes. Në këtë vit, kohëzgjatja mesatare e kthimit të përgjigjes ka qenë 23 ditë kalendarike, që tregon rikthimin e situatës së viteve 2018 - 2021. Kjo mesatare është shumë më e gjatë se afati ligjor, duke demonstruar se autoritetet publike nuk janë nën presionin e ligjit në këtë aspekt, pavarësisht se është rritur numri i përgjigjeve të plota.

4.1.4. Reagimi i autoriteteve publike pas dorëzimit të ankimit administrativ

Reagimi i autoriteteve pas dorëzimit të ankimit administrativ te Komisioneri për vitin 2023 rezulton si më poshtë:

Kthimi i përgjigjeve pas ankimit administrativ




Për vitin 2023 duket se vijon regresi sa i takon reagimit të autoriteteve pas ankimit tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Siç vihet re edhe në grafik, niveli i përgjigjeve në

masën 75% është më e ulët se viti i kaluar dhe vijon në trendin rënës që nga viti 2020. Ky reagim në rënie demonstroi se autoritetet po ndikohen më pak nga masat e mundshme që mund të merren ndaj tyre.

4.1.5. Kohëzgjatja e reagimit të autoriteteve publike pas ankimit administrativ


Pas ankimit tek Komisioneri, është bërë e zakonshme tashmë që të ketë një reagim dhe vënie në lëvizje e autoriteteve për të dhënë informacionin e kërkuar. Pas ankimit, kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes për vitin 2023 shtohet edhe më 20 ditë të tjera kalendrike. Kjo kohëzgjatje është pak më e shkurtër se ajo e vitit 2022 dhe e njëjtë me atë të vitit 2021.

**Kohëzgjatja e përgjigjes pas ankimit administrativ
(ditë kalendrike)**



4.1.6. Vlerësim agregat

200 kërkesa për informacion




4.2. Vlerësimi i transparencës proaktive

Ligji “Për të drejtën e informimit” sanksionon në nenin 7 të tij se çdo autoritet publik duhet të publikojë programin e transparencës duke përfshirë një sërë informacionesh që në mënyrë të përmblodhur përfshijnë: përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik, legjislacionin, informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, koordinatorin e të drejtës për informim, të dhëna për buxhetin, të dhëna për prokurimet publike, raportet dhe auditimet etj.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2023, sa i takon programeve të transparencës, ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e autoritetit publik për të shënuar dhe përditësimet e informacionit të publikuar. Rolin kontrollues e luan Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili monitoron në mënyrë periodike zbatimin e ligjit për publikimin e programave të transparencës. Për vitin 2023, nga ana e Komisionerit janë marrë 9 vendime me gjobë sa i takon transparencës proaktive.

4.2.1. Programet e transparencës

Qendra Res Publica në monitorimin e saj për vitin 2023 është fokusuar edhe në monitorimin e programeve të transparencës së autoriteteve publike. Për vitin 2023 janë monitoruar 100 autoritetet publike më të rëndësishëm, përmeshja e të cilave rezultojnë si më poshtë:



Siç shfaqet në grafik, në vitin 2023 ka një përmirësim të dukshëm të përmeshjes së programeve të transparencës, duke ndjekur të njëjtin trend pozitiv të nisur nga viti 2020 kur rezultojnë që vetëm 18% e autoriteteve kishin përmeshur kënaqshëm programin e transparencës, duke u rritur çdo vit me rreth 10% deri në vitin 2023.


Numri i autoriteteve publike që nuk kanë program transparence mbetet në të njëjtat shifra dhe përmirësimi rezultojnë vetëm te autoritetet që e kanë një program të tillë.

Megjithë përmirësimin e sipërpërmendur në tre vitet e fundit, situata mbetet ende problematike. Ndër 100 autoritetet publike më të rëndësishëm në vend, ende 10 prej tyre nuk kanë fare një program transparence, ndërsa gjysma e pjesës tjetër kanë përbushur pjesërisht programet e transparencës.

Në vitin 2023 për herë të parë shfaqet një autoritet publik i cili e ka përbushur plotësisht programin dhe ky është vetë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pas hyrjes në fuqi të amendamentit të ligjit për të drejtën e informimit, më 4 Nëntor 2023, janë shfaqur shenjat e para të përditësimit të programit, ku spikat Bashkia Lezhë. Megjithatë, është ende herët për të vlerësuar këtë aspekt, pasi në periudhën e monitorimit, koha në dispozicion ishte më pak se dy muaj. Për të bërë një vlerësim më të plotë nevojitet të monitorohet viti 2024.

Në vitin 2023, niveli i përgjithshëm rezulton të jetë rritur në masën 47.7% nga 39.5% që ishte në vitin 2022. Sipas llojit të autoriteteve, gjendja gjatë vitit 2023 paraqitet si më poshtë:




Siç vihet re, të gjitha kategoritë vazhdojnë të jenë ende larg standardeve të duhura. Autoritetet kushtetuese dhe ato të pavarura vijojnë të paraqiten në një nivel më të mirë se kategoritë e tjera dhe kanë një përmirësim të vogël në krahasim me një vit më parë. Përmirësim të ndjeshëm kanë shënuar kategoritë e autoriteteve të vartësisë të pushtetit ekzekutiv dhe autoritetet e drejtësisë, ndërsa më pak përmirësim shënon kategoria e pushtetit vendor.

Përkeqësim të lehtë ka shënuar vetëm kategoria e autoriteteve qendrore të pushtetit ekzekutiv. Ndër autoritetet publike të këtyre kategorive, shembujt konkretë pozitivë dhe negativë për vitin 2023 janë sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shembulli më pozitiv	Shembulli më negativ
Kushtetuese & të pavarura	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Kuvendi i Shqipërisë
Ekzekutivi qendror	Ministria e Brendshme	Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin
Ekzekutivi vartësie	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime	Drejtoria Rajonale e Kufirit
Pushtetit vendor	Bashkia Lezhë	Bashkia Kavajë
Drejtësia	Prokuroria e Përgjithshme	Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka paraqitjen më të mirë përse i përket plotësimin të kërkesave të ligjit, duke grumbulluar për herë të parë 100 pikë nga 100 të mundshme. Vihet re edhe në këtë vit që në pjesën më të madhe në programet e transparencës, mungojnë informacione që vërtet kanë vlerë për t'u publikuar ku spikat mangësia pothuajse totale e informacionit për monitorimin e kontratave të prokurimit publik dhe/ose koncesioneve (përmbushur vetëm në afro 3% të rasteve).

Llojet e informacionit të kërkuar



4.2.2. *Krahasimi mes vlerësimit të qendrës Res Publica dhe atij të Komisionerit për të Drejtën e Informimit*

Në vitin 2023 është hera e parë që Komisioneri për të Drejtën e Informimit publikon një raport të titulluar “Indeksi i transparencës”. Ky raport është një matje e transparencës proaktive, sipas mënyrës se si e sheh Komisioneri. Për të bërë një vlerësim krahas krahas, nevojitet që vlerësimi i qendrës Res Publica të modifikohet në kategoritë që ka zgjedhur Komisioneri. Më poshtë jepet një krahasim i këtyre vlerësimeve.

Vlerësimi i përgjithshëm

	Res Publica	Komisioneri për të Drejtën e Informimit
Përbushur plotësisht	1%	16%
Përbushur kënaqshëm	46%	67%
Përbushur pak	43%	17%
Pa program transparence	10%	>1%

Siç vihet re, Komisioneri ka vlerësuar si përbushje të plotë më shumë raste se ato të vlerësuara nga Res Publica, ose më saktë, 16 herë më shumë. Një fakt i tillë nuk na rezulton nga monitorimi ynë.

Gjithashtu, sipas Komisionerit rezulton se vetëm 1/6 e autoriteteve publike kanë përbushur pak programet e transparencës, ndërkohë që sipas Res Publica kjo shifër është pranë gjysmës. Sipas Komisionerit, vetëm një autoritet në mbi 300 të monitoruar, nuk ka program transparence dhe është vlerësuar me 0 pikë. Res Publica ka konstatuar të paktën 10 nga 100 autoritete publike pa program transparence.

4.2.3. *Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve*

Përveç plotësimi të programeve të transparencës, një detyrim tjetër për autoritetet publike është dhe mbajtja e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Krahas publikimit të regjistrit në faqen zyrtare të vetë autoritetit, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve publikohet edhe në portalin pyetshtetin.al, si dhe në portalin e-Albania. Një nga detyrat e lëna nga Kuvendi për Komisionerin në Rezolutën datë 08.06.2023 “Mbi vlerësimin e punës së Komisionerit për vitin 2022” është edhe:


...të nxisë shtrirjen e instalimit të Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPD) në sa më shumë autoritete publike, si dhe të mundësojë ndërthurjen e tij me shërbimet që ofrohen nga AMS/e-Albania, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit³.

Sipas përgjigjes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, aktualisht numri i autoriteteve publike për të cilat është instaluar Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit është 222.

Nga monitorimi i 100 autoriteteve kryesore rezulton se: 20% e tyre nuk kanë një regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve.

Ndërkohë për autoritetet që kanë të publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, rezulton se për vitin 2023, 15% e autoriteteve, përveç plotësisht të regjistrimit, kanë edhe akses mbi përgjigjet e dhëna, ndërsa 24% kanë një përmbledhje të përgjigjes së dhënë dhe 61% e autoriteteve nuk japin akses te përgjigjet.

Plotësimi i regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve



Në grafik, gjatë vitit 2023 vihet re një përmirësim i përmbushjes së regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve në krahasim me vitin 2022, por ende 20% e autoriteteve nuk kanë një regjistër, situatë kjo e ngjashme me dy vitet e kaluara.

4.2.4. Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit

Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit është përmirësuar lehtë, nga 89% në 90%. Megjithatë, mbetet shqetësuese që edhe 1/10 e institucioneve nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, ose të paktën nuk e kanë bërë këtë gjë publike.

³ Shiko Rezolutë "Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022", pika 4, faqe 2.

V. ÇËSHTJE ME INTERES TË VEÇANTË PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT GJATË 2023

Res Publica, edhe këtë vit, përveç monitorimit të zakonshëm të veprimtarisë së autoriteteve publike në kuadër të respektimit të së drejtës së informimit, sjell në vëmendje edhe çështje që lidhen me aspekte të veçanta të kësaj të drejte, problematika të evidentuara dhe më herët, të cilat ende sot mbeten të pazgjidhura, duke shtruar kështu debate juridike që përfshijnë edhe përplasjen mes të drejtës së informimit dhe të drejtave të tjera, apo edhe dukuri të reja të evidentuara gjatë vitit 2023.

5.1. Agjencia e Medias dhe Informimit (AMI) trajton më pak kërkesa për informacion nga sa pritej

Agjencia e Medias dhe Informimit u krijua në fund të vitit 2021 me qëllim sigurimin e transparencës në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet, si dhe qëllimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore. Këto përcaktohen në nenin 1 të VKM ne. 512, datë 19.09.2021, me të cilën u krijua ky organ. Në këtë akt, përcaktohen edhe përgjegjësitë e kësaj agjencie, të cilat janë:

1. *Organizon punën për të informuar dhe komunikuar me publikun dhe median;*
2. *Organizon punën për të përgatitur qendrimet dhe sondazhet qeveritare mbi çështjet me interes publik.*

Më specifikisht, në detyrat e caktuara për këtë agjenci përshihen ndër të tjera dhe:

- Drejtimi e koordinimi i punës së strukturave/nëpunësve përgjegjës për informimin e komunikimin mediatic dhe çështjet publike, si dhe koordinimi i organizimit të aktiviteteve informuese, konferencave për shtyp dhe çdo event publik të këtyre institucioneve;
- Vlerësimi, përmbledhja dhe përditësimi i informacionit që do të publikohet, në lidhje me punët e Këshillit të Ministrave dhe administratës shtetërore në varësi të tij, si dhe çështjet me interes publik;

- Sigurimi i përgjigjeve për shkresat dhe kërkesat për informacion, në lidhje me çështjet e informimit dhe komunikimit mediatik apo çështje të tjera në fushën e saj të përgjegjësisë si dhe koordinimi, drejtimi i fushatave të informimit publik në lidhje me çështjet e fushës së përgjegjësisë së ministrive dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore.


Në raportin e vitit 2022 kemi trajtuar gjerësisht mundësinë e mbivendosjes që mund të krijohej mes përgjegjësive të kësaj Agjencie dhe përgjegjësive që ligji për të drejtën e informimit ua ngarkon autoriteteve të tjera⁴. Përveç këtij fenomeni, ajo që vihet re gjatë vitit 2023 është numri i vogël i kërkesave për informacion të drejtuara kësaj agjencie dhe të trajtuara nga ajo, ndërkohë që ky është viti i dytë i veprimtarisë së saj. Nga një përgjigje zyrtare lidhur me veprimtarinë e AMI, për sa përket të drejtës së informimit, për vitin 2023 rezultojnë se janë bërë në total 70 kërkesa, afro më pak se 6 kërkesa në muaj. Ky numër, ndonëse më i lartë se i vitit 2022, mbetet ende një numër i papërfillshëm nëse e krahasojmë me numrin e kërkesave për informacion që trajtohen sipas ligjit për të drejtën e informimit nga të gjithë autoritetet publike.

Ndërsa është e pamundur të dimë numrin e kërkesave për informacion drejtuar të gjithë autoriteteve, të paktën dijmë që janë depozituar 956 ankesa për refuzim informacioni në zyrën e Komisionerit për vitin 2023 dhe duke marrë parasysh që sipas testit të bërë nga Res Publica, numri i kërkesave në raport me ankesat potenciale është tre herë më i lartë, që do të thotë se janë depozituar të paktën 3000 kërkesa për informacion gjatë vitit 2023 (pa përfshirë ato kërkesa që nuk janë ndjekur me ankim nga kërkuessit), që gjithsesi shpreh një interes të lartë për informacion që e tejkalon shumë herë numrin prej 70 kërkesash në vit që trajton AMI. Duhet theksuar se ky numër kërkesash të trajtuara nuk tregon domdoshmërisht aksesin në informacion. Në këtë numër futen edhe kërkesat e trajtuara me delegim. Nga të dhënat e ofruara nga AMI nuk jepet informacion sa herë kërkuessit i është siguruar informacioni.

Megjithatë edhe sikur të gjitha kërkesat të rezultojnë me sigurim informacioni, përsëri numri i kërkesave mbetet në nivele të ulëta. Në këtë kuptim, edhe në aspekt të efencës, veprimtaria e kësaj agjencie mund të konsiderohet e pamjaftueshme për efekt të informimit retroaktiv dhe shpenzim burimesh financiare dhe njerëzore, i cili merr më shumë kuptim nëse konsiderohet që objekti kryesor i veprimtarisë së AMI nuk është informimi i publikut për ato tema që publiku ka nevojë të informohet, por për ato tema që qeveria mendon se duhet të informojë publikun.

Kërkesat janë bërë kryesisht nga gazetarë dhe media, konkretisht sipas grafikut në vijim.

Numri i kërkesave sipas kategorive



⁴ <https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2023/09/E-drejta-e-informimit-2022-Res-Publica-NED.pdf>

Ajo që mbetet për t'u ripërsëritur edhe këtë vit dhe që konstatohet jo vetëm nga leximi i VKM të krijimit të agjencisë, por tashmë edhe nga praktika administrative gjatë vitit 2022 e në vazhdim, është se një ndër përgjegjësinë e AMI - informimi dhe komunikimi me publikun dhe median - është edhe përgjegjësi e autoriteteve publike, mbajtëse të informacionit, sipas ligjit për të drejtën e informimit. Pra, kjo strukturë, *de facto* nuk mund të japë informacionin drejtpërdrejtë tek qytetari/subjekti kërkues, pasi praktikisht nuk është mbajtëse e informacionit. Për këtë arsye dhënia e kompetencës për të dhënë informacion kësaj agjencie, krijon më shumë konfuzion me pasojë në konsum energjie dhe kohe. Përsëri informacioni jepet nga autoritetet kompetente në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.

Nga sa më sipër dhe në mënyrë të përmbledhur ritheksojmë se krijimi i Agjencisë për Media dhe Informim krijon disa shqetësime të renditura më poshtë:

1. Centralizimi i një aktiviteti në parim nuk i shërben demokratizimit dhe rasti në fjalë nuk bën përjashtim. Kështu, në çdo institucion të nivelit të lartë qendror dhe vendor, funksionet e parashikuara në VKM-në në fjalë kryhen tipikisht nga zëdhënësi i shtypit, zyrat e marrëdhënieve me jashtë, kabineti i titullarit, koordinatorët për të drejtën e informimit etj. I vetmi funksion i parregullar më parë është centralizimi i aktivitetit të këtyre strukturave, që tashmë synohet të jenë në varësi të Agjencisë, ku kjo e fundit është në varësi direkte të Kryeministrit.
2. Krijimi i kësaj agjencie në mënyrën si është konceptuar nuk ndihmon në informimin më të mirë dhe më të shpejtë të publikut - zgjat burokracinë edhe me një organ tjetër, i cili administron këto kërkesa e më pas ia delegon autoriteteve përgjegjëse – si dhe nga ana tjetër shton kontroll të strukturuar mbi informacionin që hyn e del në zyrat e pushtetit ekzekutiv dhe nga zyra e Kryeministrit. Të gjitha dispozitat e këtij akti sugjerojnë këtë konkluzion.
3. Praktika administrative dy vjeçare e AMI në aspekt të së drejtës së informimit, tregon për një numër shumë të vogël të trajtimit të kërkesave për informacion, gjë që nuk justifikon nga pikpamja e efikasitetit dhe përdorimit të fondeve publike funksionin e kësaj Agjencie të paktën në aspekt të së drejtës së informimit, në kushtet kur kjo e drejtë garantohet nga legjislacioni i posaçëm.

5.2. Proceset legjislative gjatë vitit 2023

5.2.1. Miratimi i ligjit nr. 78/2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Kjo nismë ligjore, me shtytjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, erdhi si nevojë për ndërhyrje në ligjin për të drejtën e informimit dhe për të adresuar problematika të evidentuara nga praktika ndër vite, që prej momentit kur ligji nr. 119/2014 hyri në fuqi.

Drafti i parë u konceptua në fund të vitit 2021, dhe më pas kaloi në disa procese konsultimi, gjatë të cilave falë edhe kontributit të organizatave të shoqërisë civile, ndër to edhe Res Publica, u ndryshua ndjeshëm deri në formën përfundimtare të ligjit të miratuar në 21 Shtator 2023, hyrë në fuqi më 4 Nëntor 2023.

Res Publica, me kontribut shumë vjeçar në këtë fushë, ishte një nga kontributorët kryesorë të diskutimit teknik gjatë procesit të konsultimeve publike, që së bashku me Qendrën CLE dhe

Qendrën A.L.T.R.I., vlerësoi se projektligji kishte nevojë për shumë ndryshime pozitive nga propozimi i parë, kryesisht nëpërmjet heqjes së disa dispozitave që sillnin regres të së drejtës së informimit. Pavarësisht suksesit në këtë aspekt, drafti final mbeti përsëri i paplotësuar me dispozita të tjera, të cilat prej kohësh ishin bërë të nevojshme për të garantuar transparencë më të lartë të administratës shtetërore.

Ligji i ndryshuar është prekur në 19 dispozita nga 24 dispozita që ka gjithsej. Në pamje të parë të krijohet ideja e gati një ligji të ri, për nga sasia e dispozitave të ndryshuara. Në fakt ndryshimet më të qenësishme reduktohen në tre apo katër të tilla, siç trajtohen në vijim. Një pjesë e këtyre ndryshimeve vlerësohen si pozitive, por një pjesë mund të krijojnë problematika në zbatim.

Res Publica i qendron vlerësimit se ky ligj duhej të kishte marrë parasysh të gjitha rekomandimet e propozuara nga organizatat e përfshira në konsultimet publike, pasi këto sugjerime janë konsoliduar pas një eksperience shumëvjeçare, si në zbatimin e ligjit në tërësi, ashtu edhe për pjesë të posaçme.

Në vijim japim në mënyrë të përmbledhur: (I) ndryshimet e miratuara; (II) risitë pozitive dhe problematikat që eventualisht mund të paraqesin disa prej ndryshimeve; (III) nevojën për ndryshime të tjera ligjore sipas rekomandimeve tona.

(I) Ndryshimet e miratuara me ligjin nr 78/2023, përmbledhen si më poshtë:

1. Në ligjin e ndryshuar janë përfshirë kompetencat e Komisionerit, të cilat më herët prashikoheshin në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga ana e teknikës legislative ky është një ndryshim pozitiv. Ndërsa janë shtuar disa kompetenca të Komisionerit që lidhen me monitorime dhe dhënie opinionesh. Kështu në tërësi Komisioneri ka këto kompetenca:
 - a. shqyrton ankesat e personave të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në këtë ligj;
 - b. shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike;
 - c. kryen hetim administrativ kryesisht ose me ankesë gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;
 - ç. njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas këtij ligji apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara. Në këto raste, ai është i detyruar të zbatojë masat për ruajtjen e informacionit të klasifikuar sipas ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”;
 - d. ka të drejtën t’i kërkojë autoritetit të klasifikimit deklasifikimin e një informacioni të klasifikuar kur çmon që publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar, në përputhje me ligjin nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”. Për njohjen me informacionin e klasifikuar të NATO-s ose BE-së zbatohen rregullat për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;
 - dh. vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - e. nxit transparencën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe

- informuar për çështje të së drejtës së informimit;
- e. kryen sondazhe mbi baza vjetore në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit;
 - f. bën rekomandime për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës;
 - g. me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit;
 - gj. kryen trajnime të nevojshme dhe të vazhdueshme të koordinatorëve për të drejtën e informimit, të punonjësve të autoriteteve publike, si dhe grupeve të interesit;
 - h. kur arrin në përfundimin se janë shkelur dispozitat e këtij ligji, njofton autoritetin publik për rezultatet e hetimit administrativ dhe, sipas rastit, propozon marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësit përgjegjës.
2. Në ligjin e ndryshuar janë përcaktuar modalitete të zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit, ku për shkelje të dispozitave të këtij ligji, autoriteti publik kërkon mendimin e Komisionerit për çështjen. Ndërsa autoriteti publik vendos pavarësisht opinionit të Komisionerit, ai është i detyruar që në vendimin përfundimtar të arsyetojë edhe për pranimin ose refuzimin e mendimit të Komisionerit.
 3. Është siguruar një trajtim i vecantë financiar për nëpunësin që do të ngarkohet funksioni i koordinatorit, që përveç pagës mujore të pozicionit në të cilin është emëruar, do të përftojë edhe një shtesë për natyrë të veçantë pune për punën e tij si koordinator për të drejtën e informimit.
 4. Është kufizuar fusha e veprimtarisë së ligjit, ku janë përjashtuar trajtimi i informacioneve të arkivuara sipas ligjit për arkivat, duke u kufizuar dhënia e informacionit, sipas këtij ligji vetëm për “arkivat në veprim”.
 5. Në përgjithësi janë ulur masat administrative për kundravajtjet administrative.
 6. Janë shtuar llojet e kundravajtjeve administrative, duke përcaktuar masa për çdo shkelje të parashikuar në ligj, ndër të cilat interes paraqet rasti kur nuk zbatohet vendimi i Komisionerit që ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme.
 7. Është zhvendosur përgjegjësia për disa lloj shkeljesh nga koordinatori për të drejtën e informimit te titullari i autoritetit publik.
 8. Është sanksionuar detyrimi që autoritetet publike të raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit, lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri.
 9. Është sanksionuar e drejta e Komisionerit për të propozuar deklasifikimin e një informacioni, kur çmon që publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore, sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar.

(II) *Risitë pozitive dhe problematikat e ndryshimeve ligjore*

1. Një ndër kompetencat që i është shtuar zyrës së Komisionerit lidhet me monitorimin e zbatimit të ligjit. Kjo, në vlerësimin tonë pritet të sjelli disa pasoja:
 - Së pari, është fakt që burimet njerëzore dhe financiare të Komisionerit janë të kufizuara. Kjo raportohet nga vetë zyra e Komisionerit në sugjerimet për shtim të organikës, e shprehur kjo edhe në tryeza diskutimesh. Kjo raportohet nga zyra e Komisionerit si një nga justifikimet e pamundësisë së trajtimit të çdo ankese në kohën e parashikuar nga ligji apo të hetimit administrativ për shkelje të tjera të ligjit. Shtimi i funksionit të monitoruesit sjell shpenzim të burimeve të kufizuara dhe kjo vlerësohet si një vendimmarrje e papjekur mirë. Vendimmarrja e Komisionerit në trajtimin e ankesave, duhet të jetë funksioni kryesor i ekzistencës së Komisionerit, i cili është konceptuar nga ligji si një organ *quasi* gjyqësor, dhe ky funksion siç rezulton nga monitorimi ynë edhe për këtë vit, trajtuar më sipër, është në nivele ende tepër të ulëta. Njëlloj analizojmë vënien e sanksioneve nga ana e Komisionerit si një mekanizëm nxitës i transparencës, i cili gjithashtu rezulton në nivele tepër të ulëta në krahasim me numrin e lartë të shkeljeve të pretenduara, për të cilat paraqiten ankesa.
 - Së dyti, monitorimi është një proces që aktualisht kryhet nga organizata të shoqërisë civile, të cilat janë edhe potencialisht dhe efektivisht objektive në këtë drejtim. Ndërsa monitorimi i zbatimit të një ligji është një aspekt i rëndësishëm që duhet të kryhet edhe nga zyra e Komisionerit, kjo duhet bërë në funksion të realizimit të kompetencave të tjera të Komisionerit dhe jo si një kompetencë me vete.
 - Së treti, monitorimi nga institucioni kujdestar i ligjit rrezikon të kthehet në një politikë për të mundësuar reklamimin e “punës së mirë së institucioneve”. Lidhur me këtë është trajtuar më sipër si shembull ilustrues, se si këtë vit Komisioneri ka publikuar Indeksën e Transparencës së Institucioneve, me qëllim sondimin e transparencës së autoriteteve publike. Ideimi i këtij lloji sondazhi dhe metodologjia e përzgjedhjes dhe kategorizimit të institucioneve në grupe është prezantuar për herë të parë nga Qendra Res Publica, në studimin “E drejta e informimit 2016”, dhe më tej transparenca e institucioneve është monitoruar sipas kësaj metodologjie vit pas viti. Ndërsa vlerësojmë pozitivisht përdorimin e një modeli të ngjashëm nga Zyra e Komisionerit, ajo që vlen për t’u diskutuar është metodologjia e vlerësimit të transparencës, nga e cila rezultojnë përfundime me ndryshime tepër të dukshme mes dy vlerësimeve, ku nga njëra anë pamja që prezanton Komisioneri është tepër pozitive në drejtim të transparencës proaktive të autoriteteve publike, por nga ana tjetër pamja që prezantohet nga Res Publica është në nivele shumë më poshtë. Për më tepër lidhur me këto rezultate është trajtuar në kapitullin më sipër që trajton transparençën proaktive.
2. Me ligjin e ndryshuar janë shtuar 4 lloje të tjera të shkeljeve të detyrimeve ligjore, duke e çuar në 19 numrin e tyre, për të cilat parashikohet sanksioni me gjobë. Ndërsa realiteti është që edhe kur ky numër ishte 15, nga monitorimi i vendimeve të Komisionerit vetëm për kryesisht dy lloj shkeljesh Komisioneri ka dhënë masën administrative të vënies së gjobës, ndërsa shifrat e indeksit të transparencës dhe monitorime të tjera tregojnë për shkelje të të gjitha detyrimeve ligjore nga ana e institucioneve. Shtimi i llojeve të shkeljeve administrative nuk pritet të ndryshojë këtë realitet, ndërsa vënia në punë e

këtij mekanizmi është ai që realisht ka sjellë efekte, siç është e dukshme përmirësimi i transparencës proaktive nga viti 2022 në vitin 2023, pikërisht pas aplikimit të 9 gjobave për këtë aspekt.

3. Një ndryshim ligjor pozitiv është ngarkimi në disa raste, i përgjegjësisë së shkeljes së detyrimeve ligjore, titullarit të autoritetit publik. Përpara amendamentit, përgjegjësia ligjore i takonte vetëm Koordinatorit për të drejtën e informimit. Se si do të reflektohet kjo në praktikë, mbetet të vlerësohet në vijim. Deri tani është fakt që aplikimi i gjobave ka qenë sporadik dhe në numër të pakonsiderueshëm në raport me shkeljet.
4. Ulja e minimumit të masës administrative është një ndryshim i vlefshëm për diskutim, por i pambështetur në ndonjë studim. Fakt përsëri mbetet që numri i masave administrative është tepër i vogël.
5. Ndonëse propozimi fillestar ishte që vendimet e Komisionerit të bëheshin tituj ekzekutivë, në draftin final të miratuar ky rregullim nuk gjeti vend dhe u zëvendësua me mekanizmin e gjobës në rast të moszbatimit të vendimit të Komisionerit. Ky ndryshim teorikisht është pozitiv. Gjatë periudhës së monitoruar nuk ka pasur mjaftueshëm kohë për ta testuar këtë aspekt (që nga data 4 nëntor 2023), por kërkohet mbajtja e një vëmëndjeje të veçantë në monitorimin e viteve në vazhdim.

(III) Nevoja për ndryshime të tjera ligjore në të ardhmen, të rekomanduara gjatë procesit të konsultimit publik

1. Në rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit është e domosdoshme që të caktohet një zyrtar i pozicionit të lartë të hierarkisë së autoritetit publik, pasi praktika ka treguar se caktimi i koordinatorëve deri më sot, në një masë të madhe është bërë thjesht formalisht duke e bërë rolin e tyre jo eficient. Megjithatë, ndryshimi i propozuar për të ngarkuar përgjegjësi te çdo person që do të pengojë zbatimin e ligjit, e zbut këtë shqetësim në teori.
2. Është konstatuar përmes monitorimeve të ndryshme, që Komisioneri për të Drejtën e Informimit merr vendim vetëm për 2-5% të ankesave të paraqitura, ndërsa pjesa tjetër e ankesave rezulton që “të zgjidhet me mirëkuptim” me autoritetet publike. Në praktikë është testuar që sidomos gazetarët kanë mbetur të pakënaqur nga këto zgjidhje sepse nuk kanë marrë realisht informacionet, ose i kanë marrë ato shumë kohë më vonë, kur lajmi ka humbur aktualitetin. Kjo praktikë nuk është në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, por neni 24 i ligjit nr. 119/2014 ka krijuar një premisë duke mos e detyruar shprehimisht Komisionerin të marrë vendim në çdo rast ndaj ky shqetësim praktik duhet të gjejë një zgjidhje, si p.sh duke shtuar një formulim si: “*Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim në afatin e parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës. Në çdo rast, edhe pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet në ankesën e paraqitur dhe të marrë vendim të arsyetuar.*”
3. Caktimi i modaliteteve dhe kriterëve për masën e shpërblimit të dëmit në rastin e mos dhënies së informacionit të tilla si: cilësia e kërkuesit, rëndësia e informacionit, vonesa, sjellja e autoriteteve publike, etj. Kjo do të shkonte në një linjë edhe me ndryshimet e

ngjashme që janë bërë në Kodin Civil (shtimi i nenit 647/a) për kriteret e vlerësimit të dëmit jopasuror në rastet e shpifjes e fyerjes. Mospërcaktimi i modaliteteve të tilla, e pamundëson në praktikë shpërblimin e dëmit, pavarësisht se ligji parimisht e njeh këtë të drejtë. Në praktikë, në Gjykatën Administrative janë paraqitur 6 raste të dëmshpërblimit për refuzimin e dhënies së informacionit, ku vetëm në një rast gjykata ka pranuar padinë. Por edhe në këtë rast, vlera e dëmshpërblimit ishte simbolike, pa sjellë efekte reale në praktikë.

5.2.2. Propozimi i ndryshime të reja ligjore pas vetëm 5 muajsh të ndryshimit të ligjit, me iniciativë të tre deputetëve

Në një kohë tepër të shkurtër, vetëm 5 muaj pas miratimit të ndryshimeve të trajtuara më sipër, një tjetër draft për disa ndryshime në ligjin për të drejtën e informimit iu propozua Kuvendit me iniciativë të tre deputetëve⁵. Ndryshimet e reja të propozuara i referohen dhënies së një pozicioni të privilegjuar deputetëve, në aplikimin e këtij ligji. Konkretisht, në draftin e propozuar parashikohet se:

“Në rast përsëritje të refuzimit të dhënies së informacionit.....kur informacioni është kërkuar nga deputeti....., Kryetari i Kuvendit, i propozon Kryeministrit shkarkimin e titullarit të autoritetit publik.

“Në rast se Kryeministri nuk vepron brenda 30 ditëve, Kryetari i Kuvendit kërkon fillimin e procedimit penal ndaj titullarit të autoritetit publik nga prokuroria përgjegjëse.”.

“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore - administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “9” dhe “h”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji. Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore- administrative për shkeljen e parashikuar në shkronjen “a”, të pikës 2, të nenit 18, në rastin kur kërkesa për informacion i drejtohet atij vetë.”

Ky draft kërkon të adresojë problemin e informimit të deputetëve si një rast i veçantë që kërkon masa të posaçme, në rast refuzimi të dhënies së informacionit.

Në vlerësimin tonë, drafti paraqet problematika që i takojnë teknikës legislative e që fillojnë me ndryshimin e një ligji në mënyrë të shpejtë dhe pa një studim paraprak për nevojën e këtyre ndryshimeve, por problematike paraqitet edhe përmbajtja.

Së pari, ligji kuadër për të drejtën e informimit është një ligj që përdoret nga publiku i gjerë, dhe nuk përmban dispozita diskriminuese pozitive për asnjë kategori, pavarësisht interesit të kategorive të ndryshme.

Në shumë raportime të bëra ndër vite nga Res Publica, është theksuar fakti se përdoruesit më të shpeshtë dhe të interesuar të ligjit janë gazetarët, të pasuar nga aktivistët, studiuesit, etj., por asnjë nga këto kategori nuk gëzon privilegje në raport me publikun e gjerë në përdorimin e ligjit.

Së dyti, deputetët gëzojnë status të veçantë sipas ligjit për statusin e deputetit që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre. Ai ligj u jep atyre privilegjet dhe detyrime të posaçme autoriteteve përkundrejt. Edhe për këtë arsye është e këshillueshme që kjo problematikë që kërkohet të gjejë zgjidhje ligjore, të adresohet pikërisht në ligjin për statusin e deputetëve.

Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se propozimi i mësipërm vjen paralelisht edhe me propozimet për ligjin “Për statusin e deputetit”⁶, në bazë të të cilës kanë kërkuar të ndryshohet:

1. *Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, nga ministrat ose nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore, si dhe nga drejtuesit e çdo institucioni tjetër në administratën publike ose të qeverisjes vendore.*
2. *Drejtuesit e institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni janë të detyruar t’i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.*
3. *Në rast shkeljeje të pikës 2 të këtij neni, njoftohet Kryetari i Kuvendit për të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.”*

5.3. Tarifat e vendosura nga autoritetet, një “doganë” për marrjen e informacionit

Edhe këtë vit janë konstatuar raste të tarifave tepër të larta për dhënien e informacionit.

E drejta për t’u informuar është një ndër të drejtat kryesore dhe kuadri ligjor që rregullon aspekte të ndryshme të kësaj të drejte është ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Midis shumë çështjeve që trajton ky ligj është edhe kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar.

Sipas nenit 13 të këtij ligji parashikohet se dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në çdo rast, kjo kosto duhet të përkojë me koston reale të riprodhimit të informacionit. Me Urdhërin nr. 86, datë 17.04.2015 “Për tarifat për dhënien e informacionit (dokumentacionit) të kërkuar” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit parashikohet se: “Tarifa e shërbimit të informacionit (fotokopje ose CD) do të jetë si më poshtë: - Deri në 10 fletë informacioni jepet pa pagesë; - Mbi 10 fletë, për formatin A4, pagesa do të jetë 5 lekë/fleta. - Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 lekë/CD.”

Së pari, vlen të theksohet përsëri se tarifat e përcaktuara nga ana e Komisionerit janë më të larta se kostoja reale në treg e shërbimit të fotokopjes, e cila ofrohet dhe me 2 lekë/fletë, ku përfshihet jo vetëm kostoja e materialit (letër dhe bojë), por edhe shërbimi, kostot indirekte, si dhe fitimi i subjektit së bashku me barrën fiskale. Dukshëm, kostoja është nën 2 lekë për fletë dhe kjo mund të reflektohet edhe në tarifat që duhen aplikuar për të drejtën e informimit.

Së dyti, pavarësisht parashikimeve të këtij Urdhëri, autoritetet publike vijojnë ende të aplikojnë tarifa të ndryshme, duke injoruar haptazi Urdhërin e sipërpërmendur. Kjo ka lënë vend për paqartësi ose edhe abuzim nga ana e autoriteteve publike.

Së treti, ndonëse ligji parashikon që informacionet e marra në rrugë elektronike jepen falas, ky rregull nuk aplikohet gjithmonë dhe autoritetet publike shpesh justifikohen me faktin që informacionin nuk e disponojnë në version elektronik, duke refuzuar të skanojnë dokumentet dhe detyruar më pas kërkuuesin të paguajë shërbimin e fotokopjes me tarifa të larta.

Nga ana tjetër, ndonëse ligji “Për të drejtën e informimit” i jep mundësinë Komisionerit, së bashku me Ministrinë e Financave, të zhvillojnë kryesisht monitorime periodike për tarifat e vendosura nga autoritetet publike me qëllim evitimin e abuzimeve, gjendja vijon të mbetet e njëjtë në disa autoritete.

⁶ <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/7bf77f3d-751d-4500-8ef0-cb0d17db85c4>

Përgjatë vitit 2023, në një rast, komuniteti i një zone (fshati Mezhgoran) në Bashkinë e Tepelenës, të shqetësuar për cenimin e burimeve ujore që preknin zonën e tyre iu drejtuan me një kërkesë Bashkisë Tepelenë ku i kërkuan informacion mbi ndërtimin e një ujësjellësi. Bashkia Tepelenë e kushtëzoi dhënien e informacionit përkundrejt një tarife prej 122.000 lekë (afro 1200 Euro).

Anëtarë të këtij komuniteti kërkuan mbështetjen e Qendrës Res Publica për trajtimin e këtij rasti. Pasi kërkesa iu drejtua Bashkisë Tepelenë, kësaj here në emër të Qendrës Res Publica, Bashkia Tepelenë vuri në dispozicion informacionin në mënyrë elektronike. Ky trajtim i diferencues i Bashkisë Tepelenë është shqetësues. Por, më pas, Bashkia Tepelenë paraqiti një faturë për arkëtim me vlerë të njëjtë me atë me lart, duke e konsideruar qendrën Res Publica si debitorë në të ardhmen. Kjo passjell nevojën që Res Publica të kundërshtojë këtë detyrim në Gjykatën Administrative të Lushnjës, duke shtuar konsumin e burimeve njerëzore, kohore e monetare të subjektit, në mënyrë tërësisht abuzive.

Komisioneri i ka kërkuar Ministrisë së Financave vlerësimin e tarifave të vendosura nga autoriteti publik, por edhe pas disa viteve nuk ka një qendrim final lidhur me këtë problem. Kjo reflekton neglizhencën e autoriteteve publike dhe indiferencën për të adresuar këtë problematikë duke mbajtur peng për rrjedhojë individët që kërkojnë lëvrimin e informacionit. Duke marrë në konsideratë faktin se qendrimet e ndryshme të autoriteteve publike për tarifën kanë vështirësuar aksesin e qytetarëve në të drejtën për informim, unifikimi i procesit të përcaktimit të tarifave nga Komisioneri në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të evitonte maksimalisht abuzimet dhe paqartësitë nga ana e autoriteteve. Komisioneri gjithashtu duhet të vendosë rregull në lidhje me prodhimin e informacionit të skanuar, i cili duhet të prodhohet nëse kërkohet nga kërkuesi. Shpesh, nuk është problemi te kostoja e riprodhimit të informacionit, më shumë se te fakti i burokracive që shoqërojnë këtë procedurë, që nisim me faktin që kërkuesi duhet të shkojë te autoriteti publik, të tërheqë një kopje të faturës, të shkojë më pas në një bankë të caktuar për të bërë pagesën dhe më pas të shkojë përsëri te autoriteti publik të tërheqë informacionin, pasi tregon dokumentin e pagesës në zyrën e financës, edhe në ato raste kur kostoja është më pak se 200 lekë. Kështu, pagesa shndërrohet në rritje vështirësie dhe shpenzim kohe, kosto shtesë si komisionet bankare, duke bezdisur dhe dekurajuar kërkuesin.

5.4. Autoritetet publike refuzojnë dhënien e informacionit edhe pasi Gjykata vendos dhënien e tij, duke u bërë pengesë për ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës

Një dukuri që po vihet re është refuzimi i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor për detyrimin e dhënies së informacionit, nga ana e nëpunësit përgjegjës të autoritetit publik.

Pas dhënies së vendimeve gjyqësore me ekzekutim të menjëhershëm, kërkuesit e përfaqësuar nga Res Publica i janë drejtuar Zyrës së Përmbarrimit për të ekzekutuar këto vendime. Raste konkrete i përkasin gazetarëve M.D dhe A.R. Pasi Zyra e Përmbarrimit filloi ekzekutimin e vendimeve, Sekretari i Përgjithshëm si personi përgjegjës, kundërshtoi veprimet përmbarrimore, ku në dy raste kanë qenë vendosje gjobe për pengim të ekzekutimit të vendimit.

Ky mekanizëm ligjor i kundërshtimit të veprimeve përmbarrimore përdoret nga debitorin (në rastin konkret autoriteti publik), në rastet kur përmbarruesi kryen shkelje në procedurën e

ekzekutimit, për shembull ngatërron debitorin, ose nuk ka njoftuar më herët për ekzekutim vullnetar, e të tjera shkelje ligjore. Në rastet e trajtuar, argumentat e palës shtet, çuditërisht i janë referuar jo veprimeve të kundraligjshme të përmbartuesit, por argumenteve pse gjykata ka vlerësuar gabim dhënien e informacionit në mënyrë të menjëhershme. Kjo sjellje abuzive me të drejtën e padisë nga ana e përgjegjës, i cili është gjobitur me të drejtë nga përmbartuesi gjyqësor, tregon mungesë serioziteti dhe madje guxim të nivelit të lartë, duke konsideruar se mos ekzekutimi ose pengimi i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor mund të shkojë deri në nivelin e veprës penale dhe përgjegjësi (në rastin konkret një nëpunës) rrezikon ndjekjen penale për këtë sjellje.

Për sa i takon transparencës së autoriteteve publike, kjo sjellje edhe pse sporadike, tregon për një mungesë vullneti ekstrem për të dhënë informacionin e kërkuar në këto raste.

5.5. Asnjë hap pozitiv drejt transparencës së veprimtarisë të sistemit gjyqësor

Në epokën e sotme dixhitale e drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale janë dy të drejta thelbësore të individit. E drejta për informim i referohet të drejtës së qytetarëve për të aksesuar informacionin e mbajtur nga autoritetet publike, ndërsa e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është e drejta e individëve për të kontrolluar përdorimin e të dhënave të tyre personale. Megjithatë, shpesh ka një konflikt midis këtyre dy të drejtave dhe zbatimi i Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (General Data Protection Regulation - GDPR) ka ngritur disa polemika.

GDPR hyri në fuqi në maj 2018 dhe përcakton rregullat se si duhet të mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në Bashkimin Evropian (BE). Ajo u jep individëve më shumë kontroll mbi të dhënat e tyre personale, duke përfshirë të drejtën për të hyrë, korigjuar dhe fshirë të dhënat e tyre. GDPR zbatohet për të gjithë subjektet që operojnë në BE, pavarësisht se ku ndodhen, dhe ka implikime të rëndësishme si për të drejtën e informacionit ashtu edhe për të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga njëra anë, GDPR forcon të drejtën për mbrojtjen e të dhënave duke u kërkuar subjekteve të marrin pëlqimin e individëve përpara se të mbledhin të dhënat e tyre dhe t'u ofrojnë atyre informacion të qartë se si do të përdoren të dhënat e tyre. Ajo gjithashtu u jep individëve të drejtën të dinë se çfarë të dhënash kanë subjektet për ta dhe të kërkojnë që të dhënat e tyre të fshihen. Ky është një hap drejt fuqizimit të individëve për të kontrolluar të dhënat e tyre personale dhe është mirëpritur nga advokuesit e privatësisë.

Nga ana tjetër, GDPR është kritikuar për cenimin e së drejtës për informim. Për shembull, sipas GDPR, subjekteve mund t'u kërkohej të fshijnë të dhënat që nuk nevojiten më, gjë që mund të nënkuptojë humbjen e të dhënave historike. Kjo mund të ketë implikime serioze për gazetarët, studiuesit dhe të tjerët që mbështeten në aksesin në të dhënat historike për punën e tyre. Ka pasur gjithashtu shqetësime se GDPR mund të përdoret për të kufizuar lirinë e shprehjes, pasi individët mund të jenë në gjendje të përdorin *të drejtën për t'u harruar* për të hequr informacionin rreth tyre nga interneti.

Një tjetër polemikë rreth GDPR është barra që u ngarkohet subjekteve për të përmbushur kërkesat e këtij rregullimi. Shumë biznese të vogla kanë luftuar për të respektuar GDPR,

pasi mund të mos kenë burimet për të zbatuar masat e nevojshme. Kjo ka çuar në kritika se GDPR është një barrë tepër e rëndë dhe ka krijuar një disavantazh konkurimi për kompanitë më të vogla.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) ka trajtuar disa aspekte themelore, si zbatueshmëria e saj globale dhe përkufizimi i “interetit publik”. Vendimet e kësaj gjykate nënvizojnë kompleksitetin e balancimit mes të drejtave të privatësisë individuale dhe të drejtës së publikut për akses në informacion. Qasja e GJED është kritikuar për vendosjen e përgjegjësisë së gjyqimit të këtyre balancimeve mbi kompanitë private, si Google, duke ndikuar kështu në lirinë e shprehjes dhe të informacionit.

Në përmbledhje, e drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave janë të dyja të drejta thelbësore që duhen respektuar. GDPR ka bërë përparim të rëndësishëm në forcimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave, por gjithashtu ka çuar në disa polemika rreth të drejtës për informim. Është thelbësore të arrihet një ekuilibër midis këtyre dy të drejtave dhe të sigurohet që individët të mund të kontrollojnë të dhënat e tyre personale duke ruajtur gjithashtu aksesin në informacionin që është në interesin publik. Ndërsa teknologjia vazhdon të evoluojë, ka të ngjarë që do të ketë debate të vazhdueshme rreth mënyrës se si të balancohen këto dy të drejta dhe do të jetë e rëndësishme të vazhdohet të monitorohet zbatimi i GDPR dhe implikimet e saj si për të drejtën për informacion ashtu edhe për të drejtën për të mbrojtur të dhënat.

Debati i mësipërm për procesin e anonimizimit të të dhënave personale në vendimet gjyqësore ka rezultuar në fakt me ndalimin e aksesit në vendimet dhe dosjet gjyqësore. Është fakt i njohur që vendimet gjyqësore, të paktën në rastin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kanë qenë publike deri në vitin 2017. Sot jemi në një situatë kur faqet online të gjykatave të mbledhura në një domain të vetëm (gjykata.gov.al), nuk ofrohet mundësia e konsultimit të vendimeve gjyqësore, madje as për avokatët apo profesione të tjera që këto dokumenta i kanë burim informacioni për aktivitetin e tyre të përditshëm profesional. Avokatët mund të marrin informacion vetëm mbi çështjen ku përfaqësojnë një palë konkrete, përmes një kodi (de)anonimizimi.

Fryma për mospublikim të vendimeve gjyqësore, por edhe refuzimi për të informuar mbi dokumentacionin që përmban dosja gjyqësore, pasi vendimi ka marrë formë të prerë, shihet të jetë prezent edhe në veprimtarinë e organeve të reja të gjyqësorit. KLGJ në strategjinë për komunikimin me gjykatat, 2022-2025⁷ nuk parashikon asnjë përmirësim të kësaj sate, madje ky shqetësim i ngritur shpesh në media nga gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile edhe këtë vit është injoruar tërësisht.

Anonimizimi i vendimeve gjyqësore ka nisur më herët me një iniciativë për të rishikuar Urdhërin nr. 15/2011 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, për të cilin ende nuk jemi në dijeninëse është miratuar apo braktisur. Në formë drafti, ky Udhëzim titullohej “Për mënyrën e publikimit të vendimeve gjyqësore në portalin elektronik të gjykatave si dhe në faqet zyrtare të internetit të gjykatave” por në thelb kufizon aksesin e publikut në vendimarrjen gjyqësore.

Në vijim ritheksojmë disa konsiderata të autorëve të këtij studimi se pse mospublikimi i vendimeve gjyqësore dhe të dhënave të tjera gjyqësore të marra në seanca publike nuk është i drejtë dhe në përputhje me një gjykatë të hapur.

a. Sipas parimit “open justice”, veprimtaria gjyqësore është e hapur, përveç rasteve përjashtimore

Aksesi në veprimtarinë gjyqësore (aksesi në dosje dhe në vendim) duhet të jetë pa limit (rregull), përveç rasteve të caktuara (përjashtimi). Parimi i mësipërm e gjen mbështetjen në filozofinë e drejtësisë së hapur⁸. Që me krijimin e gjykatave, ato u krijuan me idenë e të qenit publike. Vetë emri i tyre sugjeron fjalën “oborr”, pra gjyqet në vende të hapura. Ky parim është trupëzuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42, sipas të cilit:

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 146, pika 2 e Kushtetutës sanksionon detyrimin pozitiv që:

“Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.”

Të njëjtin qëndrim mban edhe GJEDNJ, ku në çështjen *Dadashbeyli kundër Azerbajxhanit*, 3 dhjetor 2020, citon se:

“...zhvillimi i seancave publike mbron parimin themelor të nenit 6^ç1. Karakteri publik i procedimit mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në fshehtësi, pa vëzhgim publik; është gjithashtu një nga mjetet me të cilat mund të ruhet besimi në sistemin gjyqësor. Administrimi i drejtësisë në publik i jep asaj legjitimitet. Duke e bërë administrimin e drejtësisë transparente, publiciteti kontribuon në përmbushjen e qëllimit të nenit 6^ç1, përkatësisht një gjykim të drejtë, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të Konventës (shih Boshkoski k. Maqedonia e Veriut, nr. 71034/13, § 39, 4 qershor 2020, për referenca të mëtejshme). Ekziston një pritsëmëri e lartë për publicitetin në procedurat e zakonshme penale, të cilat kanë të bëjnë me individë të rrezikshëm.” (paragrafi 24)

Qendra Res Publica është bërë pjesë e këtij procesi në cilësinë e palës së tretë.

b. Gjykimin me dyer të mbyllura dhe ruajtjen e të dhënave personale mund ta vendosi vetëm gjyqtari i çështjes (sipas kodeve të procedurave)

Kodet e procedurave, në frymën e parimit të sipërcituar, kanë rregulluar ato raste kur përjashtimisht duhet të sakrifkohet transparenca me qëllim mbrojtjen e privatësisë apo të dhënave personale. Për këto raste ligjvënësi i ka lënë detyrë dhe diskrecion gjyqtarit, i cili, për shkak të njohjes me detaje të çështjes, ka mundësinë të vlerësojë nëse duhet të “sakrifkohet” transparenca apo jo dhe seancat të zhvillohen me dyer të mbyllura sipas rastit. Çdo urdhërim ndryshe krijon një ndërhyrje në diskrecionin e gjyqtarit.

c. Pengimi i aksesit në procese, dokumentacion gjyqësor pengon avokatët, gazetarët dhe studiuesit në ushtrimin e funksioneve të tyre

Aksesi i avokatëve në përgjithësi në çdo dosje gjyqësore edhe kur nuk është palë vetë, është e domosdoshme për të rritur eficientësinë dhe profesionalizimin në punës së tyre dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve që përfaqëson. Një avokati i duhet të marrë një provë e cila gjendet në një dosje tjetër gjyqësore ku klienti i tij nuk është palë (për shembull në një vendim për

⁸ https://en.wikipedia.org/wiki/Open_justice

masë arresti kur vlerësimi i masës është i lidhur me një dosje tjetër). Një avokati i duhet të këshillojë klientin e tij nëse duhet të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet mes palëve të tjera (ndërhyrja kryesore apo dytësore sipas neneve 189-191 të Kodit të Procedurës Civile), të cilat ai dhe pala që përfaqëson nuk ka si të ushtrojnë këtë të drejtë nëse nuk kanë akses në informacion, etj.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe njohja e mënyrës së arsyetimit të një gjyqtari të posaçëm, për një tipologji të caktuar çështjesh, ku avokati ka mundësinë të hulumtojë rreth botëkuptimit të gjyqtarit, për të përshtatur mbrojtjen në interesin më të mirë të klientit dhe drejtësisë.

Sistemi jonë ligjor, në shumë aspekte, ka rudimente të një sistemi inkuizitor (në kuptimin procedural penal) ku avokati ka një rol të reduktuar në hetimin për interesa të klientit të tij. Në shumë vende të Evropës, avokati nuk kufizohet në akses në informacion, edhe kur është rasti i aksesit në të dhëna sensitive siç janë të dhënat bankare, hipotekore, apo të dhëna kontraktuale të tjera, pikërisht për të realizuar më mirë mbrojtjen e interesave të ligjshme të palëve që përfaqëson. Garancia që mund të shoqërojë këtë të drejtë të avokatëve është që ata mund të konsiderohet si *kontrollues të të dhënave*, me pasojë detyrimin për të mos publikuar të dhëna jashtë ushtrimit të të drejtave procedurale dhe të themelit të palëve që përfaqëson.

Gazetarët dhe studiuesit mund të bëhen vetë mbajtës dhe mbrojtës të të dhënave personale (kontrollues të të dhënave), pikërisht për të garantuar anonimatit në rastin eventual, duke pasur mundësi të mos cenohet interesi publik (përmes aksesit në dosje).

Të gjitha këto interesa të ligjshme dhe të dobishme për shoqërinë, janë të pamundura për t'u përmbushur në eventualitetin kur vendimet gjyqësore "fshihen" pas petkut të anonimizimit të panevojshëm, nga autoritete që nuk duhet ta gëzojnë këtë kompetencë, e cila është një ndërhyrje e fortë në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe komunikimit të informacionit.

VI. TË DHËNA NGA PLATFORMA PUBLEAKS.AL

Platforma Publeaks.al është një platformë që i vjen në ndihmë çdo qytetari, gazetari, studiuesi, aktivisti të shoqërisë civile, etj., të kërkojë informacion nga autoritetet publike pa qenë nevoja që të humbasin energji dhe kohë për kërkimin dhe ndjekjen e procedurave të kërkimit të informacionit. Kjo platformë filloi funksionimin e saj që prej vitit 2016 dhe ka shërbyer për vite si një ndërmejtës ndërmjet gazetarëve/aktivistëve/qytetarëve dhe institucioneve shtetërore me qëllimin e informimit të publikut. Përgjatë funksionimit të saj, nëpërmjet kësaj platforme janë kërkuar informacione të fushave të ndryshme si mjedisi, ekonomia, prokurimet, buxheti, shëndetësia etj.

Sa i takon përdoruesve të kësaj platforme, kategoritë e individëve që kërkojnë informacion janë të larmishme. Më poshtë pasqyrohen aplikimet në këtë platformë duke e krahasuar përdorimin e saj me vitet e mëparshme.

Lidhur me aplikimet nga Publeaks.al analizohen indikatorët:


- përdorimi i Publeaks.al
- arsimi i aplikuesve
- mosha e aplikuesve
- gjinia e aplikuesve

6.1. Përdorimi i faqes Publeaks.al

Numri total i kërkesave për informacion të trajtuara nga Publeaks.al ka arritur në 2381. Një vit më parë ishte 2170.

Në vijim jepen disa të dhëna lidhur me përdorimin e faqes Publeaks.al.

Përdorimi i platformës Publeaks.al



Nga grafiku i mësipërm vihet re se interes më të madh për të vizituar platformën ka pasur në muajt Maj - Qershor 2023, ndërsa ka pasur më pak interes në Gusht 2023. Gjatë vitit 2023 përdorimi i platformës ka qenë më i pakët se vitet 2021-2022 për shkak se viti 2023 nuk ka shënuar shumë aktivitete institucionale opozitare, si dhe nuk ka qenë vit zgjedhor.


Trafiku përgjithësisht vjen nga Shqipëria, në masën 80% dhe kryesisht nga Tirana, Shkodra, Durrësi, Berati, Fieri dhe Korça, ndërkohë që 4400 persona kanë qenë vizitorë për herë të parë gjatë vitit 2023.

Nga të dhënat e Publeaks.al vihet re se 41% e përdoruesve e kanë përdorur atë përmes aplikacionit mobile, duke dëshmuar se kjo zgjidhje vijon të jetë e favorshme për përdorim.

6.1.1. Aplikantët sipas grupmoshave


Nga të dhënat e mbledhura rezultojnë që subjektet i përkasin grupmoshave relativisht të reja.

Aplikantët e Publeaks.al sipas moshës




Për vitin 2023 ka pasur më shumë aplikantë nga grupmosha 30-39 vjeç, e cila nuk ka qenë e zakonshme për vitet e kaluar ku përgjithësisht ka dominuar grupmosha 20-29 vjeç. Gjithashtu, vihet re mungesa e aplikimeve nga moshat 50+, një situatë e ngjashme kjo me vitin 2021.

6.1.2. Aplikantët sipas arsimit



Kategoria më e interesuar për të kërkuar informacion vijon të jetë kategoria me arsim të lartë. Për vitin 2023, mbizotëron arsimi i lartë master me 67%, ndërsa ka pasur dhe rritje të aplikantëve me titull akademik në masën 11%. Kjo situatë mund të vijë për shkak se kategoritë të cilët kërkojnë informacione janë persona që i përdorin këto informacione në kuadër të punës së tyre.

6.1.3. Aplikantët sipas gjinisë



Për vitin 2023 kategoria më e interesuar për të marrë informacione rezulton të jenë burrat, ndryshe nga dy vitet e fundit. Në masën 63%, burrat kanë treguar interes të shtuar për të drejtën e informimit, në masën më të lartë që nga nisja e operimit të platformës Publeaks.

VII. KONKLUZIONE

Niveli i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit edhe gjatë vitit 2023 mbetet në nivele larg pritshmërive ligjore.

Gazetarët e shfrytëzojnë ligjin për të marrë informacione me qëllim hartimin e raportimeve, investigimeve dhe analizave të tyre dhe për këtë arsye kanë nevojë të aksesojnë shpejt dhe plotësisht dokumentet e kërkuara. Aktivistët, studiuesit, etj., e përdorin ligjin për të mbështetur aktivitetet e tyre të cilat shpesh kërkojnë planifikim dhe organizim të mirë. Edhe këta kërkuar kanë nevojë të kenë siguri për të marrë informacionet në kohën dhe mënyrën e duhur.

Gjetjet e këtij studimi japin një tablo problematike të zbatimit të ligjit, e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

7.1. Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion

- Në afro 3/4 (73%) e rasteve kërkuar marrin një përgjigje të plotë pas kërkesës fillestare. Në 8% të këtyre rasteve, kërkuar marrin përgjigje të pjesshme (shpesh kjo është përgjigje pa përmbajtje, pra jo efektive, ndërsa në 27% të rasteve nuk marrin asnjë përgjigje. Ky tregues është përmirësuar dhe është në nivelin më të lartë që nga hyrja në fuqi e ligjit në vitin 2014. Në praktikë është rritur niveli i përgjigjeve të plota, por niveli i mospërgjigjeve ka mbetur në nivel të njëjtë me vitin e kaluar.
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare është rritur në raport me vitin kaluar dhe është në një situatë të ngjashme me vitet 2018-2021, duke shënuar një mesatare prej 23 ditësh kalendarike, afro 60% mbi kufirin ligjor prej 10 ditësh pune.
- Në 75% të rasteve (në trend rënës që prej vitit 2020) merret një përgjigje pas ankimit dhe kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes, ndonëse është pak më e shkurtër në krahasim me vitin e kaluar, e rrit edhe me 20 ditë të tjera kalendarike kthimin e përgjigjes.
- Në një pjesë të vogël të kërkesave, por të rëndësishme për shkak të llojit të informacionit të kërkuar (siç janë kontratat e prokurimeve, koncensioneve, etj.), autoritetet nuk japin përgjigje as pas vendimit të Komisionerit dhe shpesh as pas vendimit të gjykatës.

Reagimi ndaj kërkesave për informacion është më i ngadaltë se viti 2022, por në nivel më të lartë të përgjigjeve të plota. Edhe gjatë vitit 2023 në shumë raste përgjigjet nuk jepen brenda afatit ligjor. Në 27% të rasteve, përveç humbjes kohore është vijuar me ankime administrative dhe gjyqësore. Informacionet më sensitivë vijnë të hasin rezistencë në aksesim, deri në pikën që e humbin vlerën, sidomos për gazetarët.

Sjellja e autoriteteve publike, në një masë të madhe vijon të shfaqet indiferente ndaj detyrimeve ligjore. Në një pjesë të vogël të rasteve përdoret truku i dhënies së përgjigjeve të pjesshme dhe evazive. Komisioneri për të Drejtën e Informimit vijon të marrë shumë kohë për të trajtuar rastet, duke tejkaluar shumë shpesh afatet ligjore, dhe trajtimi i ankesave nga ana e tij nuk ka mjaftuar për të siguruar informacione të rëndësishme në të gjitha rastet.

Autoritetet publike përdorin dhe shpesh abuzojnë me çdo mekanizëm ligjor për të zvarritur dhënien e informacionit pa fund. Ato informacione që aksesohen më lehtë, pavarësisht se shpesh jashtë afateve ligjore, janë zakonisht informacione që nuk hedhin dritë mbi ndonjë veprimtari të rëndësishme shtetërore.

7.2. Për sa i përket programeve të transparencës

- Për herë të parë 1 autoritet publik nga 100 të monitoruar, e ka përmbushur plotësisht programin e transparencës me 100 nga 100 pikë të mundshme. Ky autoritet është vetë Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Asnjë prej autoriteteve të tjerë të monitoruar nuk e ka përmbushur plotësisht programin e transparencës.
- Afro gjysma e autoriteteve e kanë përmbushur gjysmën ose më shumë të kërkesave të ligjit për këto programe. Ky tregues është përmirësuar ndjeshëm nga viti 2022 dhe vijon të jetë në trend rritës që nga viti 2020.
- Pak më shumë se 40% e autoriteteve publike të monitoruara kanë informacione të reduktuara dhe shpesh herë të parëndësishme në programin e transparencës.
- 1/10 e autoriteteve publike nuk kanë fare një program transparence.
- Ka një përmirësim të kategorive të autoriteteve të vartësisë së pushtetit ekzekutiv, drejtësisë dhe pushtetit vendor. Përmirësim më i lehtë është shënuar në kategorinë e autoriteteve kushtetuese e të pavarura, ndërsa një regres i lehtë është shënuar në kategorinë e autoriteteve të pushtetit ekzekutiv qendror.
- Informacionet më shumë të publikuara kanë të bëjnë me vendodhjen e zyrave, orari i punës, emri dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit, ndërsa informacionet më pak të publikuara janë të lidhura me zbatimin dhe monitorimin e kontratave, treguesit e performancës, etj.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka bërë një vlerësim të vetin për programet e transparencës, duke e paraqitur situatën 16 herë më të mirë në përmbushjen e plotë të programeve dhe mbi 10 herë më të mirë në rastet e autoriteteve pa program transparence. Ky vlerësim nuk i përgjigjet realitetit të vëzhguar nga Res Publica.

Në kushtet kur 100 autoritetet e përzgjedhura për monitorim janë më të rëndësishmit në vend (institucionet kushtetuese, ministritë, drejtoritë më të rëndësishme, bashkitë më të mëdha dhe gjykatat e prokuroritë e rretheve më të mëdha), është e papranueshme që 99% e tyre nuk kanë përmbushur tërësisht kërkesat e ligjit. Një pjesë e madhe e tyre kanë përmbushur pak ose aspak kërkesat e ligjit. Në shumë raste programet janë të papërditësuar. Mesatarja e përmbushjes është rritur nga 39.5% në 47.7% gjatë vitit 2023, duke demonstruar se të paktën gjatë këtij viti ka një trend pozitiv. Në raport të drejtë me këtë përmirësim janë edhe sanksionet me gjobë të vendosura nga Komisioneri, ku gjatë vitit 2023 janë vendosur një numër rekord gjobash (9 të tilla) për mosplotësim të programeve të transparencës.

7.3. Për sa i përket strukturës për zbatimin e ligjit

- Ende 1/10 e autoriteteve më të rëndësishme nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, ose nuk ka bërë publike të dhënat e tij.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është plotësuar nga rreth 30% e autoriteteve, me një përmirësim në krahasim me vitin 2022, por mbetet ende në nivel mediokër.
- 1/5 e autoriteteve vijnë të mos kenë fare regjistër, ose e kanë atë tërësisht pa informacione, situatë kjo e njëjtë me atë të vitit të kaluar.
- Për 222 autoritete publike është instaluar Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Me plotësimin e kërkesave të ligjit më pak se 1/3 e autoriteteve publike më të rëndësishme, mund të thuhet se, pavarësisht përmirësimit krahasuar me vitin e kaluar, edhe kjo risi e ligjit është më së shumti e dështuar në masë të madhe. Fakti që një pjesë e rëndësishme e autoriteteve nuk marrin mundimin as të publikojnë një regjistër sa për sy e faqe, tregon për mungesën e theksuar të seriozitetit në trajtimin e këtij aspekti të rëndësishëm.

7.4. Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

- Numri i ankesave të paraqitura para Komisionerit në vitin 2023 është ulur në krahasim me vitet 2021-2022.
- Komisioneri ka marrë vendim vetëm për më pak se 5% të ankesave gjatë vitit 2023, duke vijuar të shënojë një shifër tepër të ulët në vendimmarrje.
- Komisioneri ka respektuar afatet ligjore të trajtimit të ankesave vetëm në 4% të rasteve.
- Komisioneri ka shtuar mbajtjen e seancave dëgjimore, metodë e cila rrit cilësinë e vendimmarrjes, por edhe e vonon atë.
- Sanksionet e aplikuara për refuzim informacioni vijnë të jenë të rralla, me vetëm 1 të tillë gjatë gjithë vitit 2023, në mospërputhje me gjendjen problematike që paraqitet.

Njëlloj si në periudhat e mëparshme, Komisioneri vijon të marrë shumë pak vendime në raport me ankesat e mbërritura te kjo zyrë. Gjatë vitit 2023, vetëm më pak se 5% e rasteve janë trajtuar me vendim, ndërkohë që raportimi i Komisionerit për çështjet e tjera është që janë zgjidhur me mirëkuptim, duke “iu vënë në dispozicion informacioni ankuesit”. Pavarësisht se kjo metodë është reklamuar si pozitive nga Komisioneri, ende shumë gazetarë ankohen rregullisht pranë qendrës Res Publica për mungesën e aksesit në shumë prej këtyre informacioneve.

Niveli i sanksioneve është shumë i ulët. Siç kemi raportuar edhe vitet e kaluar, është konstatuar një lidhje e drejtpërdrejtë mes sanksioneve me gjobë për programet e transparencës dhe përmirësimin e programeve të transparencës brenda një kohe të shkurtër. Dukshëm, sanksionet funksionojnë për ndërgjegjësimin e autoriteteve publike që kanë injoruar me vite kërkesat e ligjit. Përmirësimin e programeve të transparencës mund të ndikojë në uljet e fluksit të kërkesave dhe ankesave, me pasojë organizimin më të mirë të punës së vetë Komisionerit. Vetë ulja e numrit të ankesave gjatë vitit 2023 është një tregues për t’u konsideruar se mund të ketë lidhje me përmirësimin e transparencës proaktive.

7.5. Për sa i përket çështjeve të veçanta

- Vijon të pengohet publikimi i seancave dhe vendimeve gjyqësore. Kjo është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në kundërshtim me udhëzimet e CEPEJ. Kjo sjellje penguese dhe censurose e informacionit pengon gazetarët dhe qytetarët që të mësojnë rreth veprimtarisë gjyqësore, si dhe avokatët që cenohen në ushtrimin efektivisht të profesionit të tyre në dëm të qytetarëve.
- Ndryshimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kanë rëndësi dytësore, por të paktën disa zhvillime janë pozitive dhe disa dispozita problematike të draftit fillestar u eliminuan, duke mos u bërë pjesë e ligjit nr. 78/2023 që hyri në fuqi në 4 nëntor 2023. Debatet e kryera në tryezat konsultuese bënë të mundur të adresoheshin shumë shqetësime. Disa propozime të rëndësishme të shoqërisë civile mbetën ende pa u bërë pjesë e tij.
- Krijimi i Agjencisë për Media dhe Informim duket se nuk ka pasur efekt të fortë në të drejtën e informimit, pavarësisht se shfaqen raste të konfuzionit. Gjatë vitit 2023 kjo agjenci ka trajtuar vetëm 70 kërkesa, një numër shumë i vogël ky në raport me numrin total të kërkesave që i drejtohen drejtpërdrejt autoriteteve publike. Edhe kërkesat e drejtuara ndaj AMI, janë deleguar te autoritetet përkatëse, duke sjellë vonesa, burokraci dhe shpenzim burimesh të panevojshme.
- Vijon sjellja e disa autoriteteve që shfrytëzojnë të gjithë mjetet procedurale deri te refuzimi i ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, me qëllim për të mos dhënë informacione sensitive që hedhin dritë mbi veprime të dyshuara si korruptive.
- Vijon të ketë probleme me zbatimin e tarifave abuzive për marrjen e informacioneve (në raste të shpëputura) ku mungesa e një praktike unifikuese nga Komisioneri në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ka sjellë edhe raste abuzive.

Të gjitha sa më sipër, tregojnë edhe një herë nevojën për reflektim të mëtejshëm lidhur me problematika të cilat mbetën të paadresuara nga ndryshimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2023.

Gjithsesi, ndryshimet ligjore sollën disa risi, si për shembull zhvendosjen e disa përgjegjësive nga koordinatorët të titullarët e autoriteteve publike, shtimin e sanksionit për moszbatimin e vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, etj.

Anonimizimi i të dhënave është një çështje që po merr zgjidhje të pabalancuar në praktikë dhe nevojitet vëmendje e veçantë nga të gjithë aktorët. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë bërë pjesë e prishjes së kësaj balance, pikërisht sepse janë gjykata të një niveli të tillë që kuptojnë rëndësinë kushtetuese të transparencës së drejtësisë.

7.6. Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit

- Interesi për përdorimin e portalit ka qenë konstant gjatë vitit me ndryshime të vogla nga muaji në muaj, përveç muajit gusht që korespondon me pushimet e verës.
- Vijon të tregohet interes më i lartë nga persona me arsim të lartë ku një pjesë të konsiderueshme e zënë individët me arsim të lartë, niveli Master.
- Në ndryshim nga viti i kaluar, kur interesi më i lartë është treguar nga grumoshja 20 deri 29 vjeç, gjatë vitit 2023 u shfaq interes më i lartë i grupmoshës 30-39 vjeç.
- Gjatë vitit të kaluar u shtua përdorimi i Publeaks.al nga gratë, ndërsa gjatë vitit 2023 afro 2/3 e përdoruesve ishin burra.

Treguesit demonstrojnë se niveli i edukimit është faktori më kryesor që ndikon drejtpërdrejt te personat më të interesuar për të përdorur ligjin për të drejtën e informimit. Faktori moshë dhe gjini është i luhatshëm sipas rastit, në varësi të zhvillimeve socio-ekonomike e politike në vend. Larmia e informacionit të kërkuar është e gjerë.

VIII. REKOMANDIME

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe në vijim të monitorimeve të vazhdueshme që nga vitet e kaluara, rekomandojmë sa vijon:

Rekomandimi nr. 1

Rikthejmë në vëmendje që përpara hartimit dhe miratimit të Rezolutës për Vlerësimin e Punës së Komisionerit, Kuvendi i Shqipërisë të informohet edhe nga organizatat e medias e ato të shoqërisë civile

Vihet re se veprimtaria e zyrës së Komisionerit rezulton të jetë e kritikueshme zbatimi i ligjit është në nivele mediokre, pavarësisht përmirësimeve të disa pjesëve. Komisioneri nuk rezulton të ketë marrë masa të mjaftueshme për të zbatuar plotësisht rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutat e përvitshme dhe nga ana tjetër këto rezoluta, përkundrazi, japin vlerësime për punën e Komisionerit në mënyrë krejt formale dhe të pambështetura në vlerësime objektive, pa prezantuar problematikat reale me të cilat përballen gazetarët, aktivistët e qytetarët. Rekomandojmë që Kuvendi dhe komisionet e tij të marrin parasysh, përveç raporteve të Komisionerit, edhe raporte të bëra nga organizatat, si dhe të ftohen këto organizata që të marrin pjesë në seancat dëgjimore të prezantimit dhe vlerësimit të punës së Komisionerit për të Drejtën e informimit.

Rekomandimi nr. 2

Komisioneri për të Drejtën e Informimit të marrë më shumë vendime, duke trajtuar çdo ankese

Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të bëjë pjesë të praktikës së vet përgjigjen e ankimeve me vendim, si e vetmja formë që i njeh ligji për shprehjen e vullnetit. Çdo formë tjetër prodhon dhe efekte negative në garantimin e të drejtës për informim.

Rekomandimi nr. 3

Të zbatohen më shumë sanksione në rrethanat e justifikuara

Në kushtet kur vihet re se ligji për të drejtën e informimit nuk respektohet në shumë aspekte dhe kjo situatë tashmë duket si e normalizuar për shumë vite, nevojitet të forcohet respektimi i ligjit përmes zbatimit të sanksioneve. Gjatë vitit 2023, zbatimi i sanksioneve për mosplotësimin e programeve të transparencës solli përmirësimin e tyre nga 40% në 48% me vetëm 9 gjopa të marra. Për këtë arsye rekomandohet që Komisioneri të rrisë zbatimin e sanksioneve, sidomos për rastet flagrante kur refuzimi i informacionit bëhet për shkaqe neglizhence, mungese dëshire për të bërë transparencë, kundër vendimeve të Komisionerit, etj.

Rekomandimi nr. 4

Nevojitet të rishikohet draft Udhëzimi me qëllim rregullimin e anonimizimit të të dhënave në gjykata

Përsërisim edhe në këtë raport të njëjtin rekomandim të mëparshëm, për draft udhëzimin e ri për anonimizimin e vendimeve gjyqësore. Udhëzimi aktual për anonimizimin e të dhënave në gjykata, si dhe drafti i ri, janë në të njëjtën frymë, atë të kufizimit si rregull, dhe publikimit si përjashtim. Nevojitet që qasja të jetë në frymën e kundërt, atë të publikimit si rregull, dhe të anonimizimit si përjashtim, si dhe për t'ia lënë këtë kompetencë gjykatës, siç përcakton Kushtetuta, kodet dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rekomandimi nr. 5

Për paditë me objekt kërkim informacioni, vendimi i gjykatës duhet të marrë formë të prerë që në shkallë të parë

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë që në çështjet gjyqësore për aksesin në informacion, vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë që në shkallën e parë të gjykimit, ose të shqyrtohen drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Apelit, siç veprohet me rastet e prokurimeve publike. Siç e kemi thënë edhe në studimet e mëparshme, përpara dërgimit të çështjes në gjykatë Komisioneri garanton një procedurë quasi gjyqësore dhe mbyllja e mundësisë së ankimit në një gjykatë më të lartë pas asaj të shkallës së parë nuk është shkelje e procesit të rregullt ligjor sipas standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E ngjashme është edhe praktika e prokurimeve ku Komisioni i Prokurimit Publik konsiderohet si një organ quasi gjyqësor dhe ankimi bëhet drejtpërdrejt në shkallën e dytë të gjykimit administrativ. Kjo ndërhyrje ligjore do të përmbushte edhe një prej standardeve kryesore të Konventës së Tromsos, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, që është dhënia e informacionit në kohë të shpejtë dhe pa procedura të gjata.

Rekomandimi nr. 6

Rekomandohet të rishikohet kostoja e riprodhimit të dokumentave zyrtarë

Ligji përcakton parimin se informacioni jepet falas. Në raste të veçanta, ligji i lejon autoritetet publike që të kërkojnë rimbursim të kostos së riprodhimit të informacionit. Kostoja është vetëm ajo që ka të bëjë me kostot materiale dhe jo me shërbimin e kryer nga punonjësit e autoriteteve publike. Aktualisht Komisioneri ka lejuar aplikimin e “tarifave”, të cilat nuk

përbëhen vetëm nga kostoja dhe për më tepër, në disa raste tarifat janë më të larta se kostoja e fotokopjimit në tregun e lirë, e cila është çmim shitjeje. Nevojitet të rishikohet ky aspekt, në mënyrë që të shmangen pengesat abuzive në aksesin në informacion. Gjithashtu, Komisioneri duhet të kujdeset që institucionet të ofrojnë sa më shumë që të jetë e mundur, sipas kërkesës së vetë subjekteve kërkuar, dokumentat e skanuar dhe dërguar në rrugë elektronike, të cilat duhet të ofrohen pa pagesë, edhe nëse janë voluminoze.

Rekomandimi nr. 7

Rekomandohet që gazetarët të përdorin “gjqtarët e medias” për të aksesuar shpejt informacione të proceseve gjyqësore

“Gjqtarët e medias”, të përfshirë pas reformës në drejtësi të vitit 2017, ende përdoren shumë pak. Vendimet e tyre merren në një kohë të shpejtë dhe janë lehtësisht të kërkueshëm, pa procedura të komplikuar.

Rekomandimi nr. 8

Rekomandohet që ndërhyrja e propozuar nga disa deputetë, në ligjin nr. 119/2014, të rishikohet për ta bërë atë në ligjin për statusin e deputetit

Nisma e disa deputetëve për të ndërhyrë në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është një zgjidhje e gabuar sa i takon teknikës legjislative. Rekomandojmë që propozimet të zhvendosen te ligji për statusin e deputetit.

Rekomandimi nr. 9

Rekomandohet konsiderimi i disa ndërhyrjeve në ligjin nr. 119/2014, të pakonsideruara gjatë procesit konsultues të vitit 2023

Teknika legjislative nuk rekomandon ndryshime të shpeshta të ligjeve. Gjithsesi, nëse ligji do të rishikohet për arsyen e përmendur në rekomandimin e mësipërm, apo për çfarëdo arsye tjetër, është e nevojshme që të konsiderohen disa ndryshime të propozuara më herët dhe të pa konsideruara gjatë vitit 2023, si detyrimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit që të marrë vendim në çdo rast, caktimi i një zyrtari të lartë në rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit, si dhe vendosjen e përkufizimeve të qarta të dëmit që shkaktohet nga mosrespektimi i të drejtës për t’u informuar, si dhe mënyrat e matjes së dëmit, të ngjashme me ato të përcaktuara në nenin 647/a të Kodit Civil.

* * *

Tiranë, Mars 2024

Qendra “Res Publica”
“E drejta e informimit 2023
Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit -
Shumë zhurmë për asgjë?”
Mbështetur nga:
National Endowment for Democracy
Tiranë, Mars 2024
52 faqe
Formati: 21 x 29.7 cm
Tirazhi 200 kopje



RESPUBLICA

Adresa: Bul. "Gjergj Fishta",
Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

Tel.: +355 69 940 8875

E-mail: qendra.respublica@gmail.com

Web: www.respublica.org.al
www.publeaks.al

